

**VENDIM**  
**Nr. 379, datë 10.7.2025**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 20, DATË 17.1.2024,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES  
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,  
QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘LIDHJA E RRUGËS  
TRANSBALLKANIKE ME PORTIN DETAR’, VLORË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 20, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Lidhja e Rrugës Transballkanike me Portin Detar’, Vlorë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) në pikat 3 dhe 4, vlera “...182 020 370.86 (njëqind e tetëdhjetë e dy milionë e njëzet mijë e treqind e shtatëdhjetë pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë...” zëvendësohet me “...200 831 026.08 (dyqind milionë e tetëqind e tridhjetë e një mijë e njëzet e gjashtë pikë zero tetë) lekë...”;

b) në tabelën bashkëlidhur vendimit nr. 20, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

i. të dhënat për shpronësimin, që u përkasin numrave rendorë 17 dhe 18, zëvendësohen me të dhënat e pasqyruara në numrin rendor 17 të tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii. të dhënat për shpronësim të numrave rendorë 28, 29 dhe 43 të tabelës, bashkëlidhur vendimit nr. 20, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen me të dhënat me të njëjtin numër rendor të tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

iii. tabelës, bashkëlidhur vendimit nr. 20, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, i shtohen pasuritë me numra rendorë 51–55 të tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pronarët e pasurive me numrat 32/589 dhe 32/134+1-10, që janë likuiduar sipas vlerës së përcaktuar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, vetëm për diferencën e vlerës së shtuar të kompensimit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Vlorë.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME PORTIN DETAR”, VLORË

| Nr.                                | Pronari                 | ZK   | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Volum | Faqe | Truall m <sup>2</sup> | Ndërtesë m <sup>2</sup> | Adresa | Sipërfaqe truallit për shpronësim | Çmimi i truallit lekë /m <sup>2</sup> | Vlera e truallit lekë | Sipërfaqe ndërtimi për shpronësim | Çmimi i ndërtimit lekë /m <sup>2</sup> | Vlera e ndërtimit lekë | Vlera e truallit dhe ndërtesës | Shënime       |  |
|------------------------------------|-------------------------|------|----------------|------------------|-------|------|-----------------------|-------------------------|--------|-----------------------------------|---------------------------------------|-----------------------|-----------------------------------|----------------------------------------|------------------------|--------------------------------|---------------|--|
| 17                                 | Latif Reshat Totaj      | 8604 | 32/589         | Truall           | 67    | 239  | 437                   | 57                      | Vlorë  | 95                                | 6,899.00                              | 655,405.00            | 57                                | 52,296.00                              | 2,980,872.00           | 3,636,277.00                   |               |  |
|                                    | Nadire Yzeir Totaj      |      |                |                  |       |      |                       |                         |        |                                   |                                       |                       |                                   |                                        |                        |                                |               |  |
| 28                                 | Armida Bifsha           | 8604 | 32/134+1-9/1   | Apartament       | 29    | 51   | 53.12                 | 33.72                   | Vlorë  | 53                                | 6,899.00                              | 366,474.88            | 33.72                             | 52,296.00                              | 1,763,421.12           | 2,129,896.00                   |               |  |
|                                    | Esmeralda Bifsha        |      |                |                  |       |      |                       |                         |        |                                   |                                       |                       |                                   |                                        |                        |                                |               |  |
|                                    | Lefter Bifsha           |      |                |                  |       |      |                       |                         |        |                                   |                                       |                       |                                   |                                        |                        |                                |               |  |
|                                    | Thomadhda Bifsha        |      |                |                  |       |      |                       |                         |        |                                   |                                       |                       |                                   |                                        |                        |                                |               |  |
| 29                                 | Shpresë Ali Xhako       | 8604 | 32/134+1-10    | Apartament       | 22    | 189  |                       | 50                      | Vlorë  | 27                                | 6,899.00                              | 186,273.00            | 50                                | 52,296.00                              | 2,614,800.00           | 2,801,073.00                   |               |  |
|                                    | Lonard Bashkim Xhako    |      |                |                  |       |      |                       |                         |        |                                   |                                       |                       |                                   |                                        |                        |                                |               |  |
|                                    | Alfred Bashkim Xhako    |      |                |                  |       |      |                       |                         |        |                                   |                                       |                       |                                   |                                        |                        |                                |               |  |
|                                    | Elisabeta Bashkim Xhako |      |                |                  |       |      |                       |                         |        |                                   |                                       |                       |                                   |                                        |                        |                                |               |  |
|                                    | Gentiana Bashkim Rapo   |      |                |                  |       |      |                       |                         |        |                                   |                                       |                       |                                   |                                        |                        |                                |               |  |
| 43                                 | Jaho Avdulla Dano       | 8604 | 32/208/1       | Truall           | 73    | 13   | 39                    | 19                      | Vlorë  | 39                                | 6,899.00                              | 269,061.00            | 19                                | 52,296.00                              | 993,624.00             | 1,262,685.00                   |               |  |
|                                    | Vera Ferik Dano         |      |                |                  |       |      |                       |                         |        |                                   |                                       |                       |                                   |                                        |                        |                                |               |  |
| 51                                 | Agim Safet Mustafarai   | 8604 | 32/20/ND       | Ndërtesë         | 72    | 244  |                       | 41                      | Vlorë  |                                   |                                       | -                     | 41                                | 52,296.00                              | 2,144,136.00           | 2,144,136.00                   |               |  |
|                                    | Medine Ali Mustafarai   |      |                |                  |       |      |                       |                         |        |                                   |                                       |                       |                                   |                                        |                        |                                |               |  |
| 52                                 | Fatmir Xhemil Sulejmeni | 8604 | 32/638/3       | Truall           | 72    | 210  | 78                    | 100                     | Vlorë  | 78                                | 6,899.00                              | 538,122.00            | 100                               | 52,296.00                              | 5,229,600.00           | 5,767,722.00                   |               |  |
| 53                                 | Mimoza Nuri Çelaj       | 8604 | 32/641         | Truall           | 73    | 227  | 294                   | 103                     | Vlorë  | 294                               | 6,899.00                              | 2,028,306.00          | 103                               | 52,296.00                              | 5,386,488.00           | 7,414,794.00                   |               |  |
| 54                                 | Izet Qazim Zeraj        | 8604 | 32/603         | Truall           | 70    | 65   | 25                    | 25                      | Vlorë  | 1.68                              | 6,899.00                              | 11,590.32             | 25                                | 52,296.00                              | 1,307,400.00           | 1,318,990.32                   |               |  |
|                                    | Violeta Muhamet Zeraj   |      |                |                  |       |      |                       |                         |        |                                   |                                       |                       |                                   |                                        |                        |                                |               |  |
| 55                                 | Izet Qazim Zeraj        | 8604 | 32/134+1-7     | Apartament       | 18    | 95   | 40.1                  | 33.6                    | Vlorë  | 0.70                              | 6,899.00                              | 4,829.30              | 33.6                              | 52,296.00                              | 1,757,145.60           | 1,761,974.90                   |               |  |
|                                    | Violeta Muhamet Zeraj   |      |                |                  |       |      |                       |                         |        |                                   |                                       |                       |                                   |                                        |                        |                                |               |  |
|                                    | Robert Izet Zeraj       |      |                |                  |       |      |                       |                         |        |                                   |                                       |                       |                                   |                                        |                        |                                |               |  |
| Vlera totale shtesë e shpronësimit |                         |      |                |                  |       |      |                       |                         |        |                                   |                                       |                       |                                   |                                        |                        |                                | 18,810,655.22 |  |